



A.nr.720/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.720/2026, të datës 01.07.2026, të parashtruar nga ankuesi R.Z. nga Prishtina, kundër organit të punësimit/ Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.07.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.720/2026, e datës 01.07.2026, e parashtruar nga ankuesi R.Z.

A r s y e t i m

Ankuesi R.Z. (*tutje referuar ankuesi*), më datë 01.07.2026, përmes e-mailit ankesa.kpmsheck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.720/2026, kundër Vendimit me numër 07/2026 të datës 24.06.2026, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publike, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019641, për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, e shpallur nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike me datë 25.04.2026, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00019641, për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë, me afat të aplikimit nga data 26.04.2026-25.05.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, sipas Vendimit me numër 07/2026 të datës 24.06.2026, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publike, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni, më arsyetimin se dëshmitë lidhur më përvojën e punës nuk janë të përthyerë në njërin nga gjuhët zyrtare, ashtu siç kërkohet në shpalljen e konkursit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër 07/2026 të datës 24.06.2026, për refuzimin e aplikacionit, me pretendimin se refuzimi i aplikacionit është bërë në interpretim të gabuar të kritereve të konkursit duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ligjshmërinë e procesit të rekrutimit. Kërkon që të ndërmerren veprime për të siguruar zbatimin korrekt të kritereve të konkursit dhe rregullsisë së procesit të verifikimit paraprak të dokumentacionit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 01.07.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak, fakt ky i konfirmuar edhe nga DMZP-ja më datë 06.07.2026 (përmes emailit nga zyrtarja A. R.).

Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës nuk ka përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr.Ref:RN00019641, atëherë, Kolegji erdhi në përfundimin se ankesa A.nr.720/2026 e datës 01.07.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.720/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, R.Z;*
- *DMZP-së /Ministritë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*